



BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE

(Pasqyra 14/Sh)

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

SHTATOR, 2019

Buletini Mujor i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14/Sh. Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14/Sh për muajin shtator 2019 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në rrethe.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit shtator 2019 zënë 59 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14/Sh, dhe paraqesin një incidencë (470.51/100.000 banorë). Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që në nivel kombëtar, helmimet ushqimore paraqesin një incidencë (5.93/100.000 banorë). Rrethet Berat, Bulqizë, Kukës, Pogradec dhe Tiranë mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rretheve të diagnozës së saktë klinike, dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

Gjatë dhjetë ditëve të para të muajit shtator, në qytetin e Tiranës ka patur një rritje jonormale të rasteve me probleme gastrointestinale të paraqitura në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT), Tiranë. Përqindja më e madhe e pacientëve referojnë që kanë patur një klinikë të lehtë, me disa episode me diarre, të vjella, si dhe kanë patur dhimbje epigastrike të shoqëruar ose jo me temperaturë. Pjesa më e madhe e rasteve janë kthime, dhe vetëm 3.5% e totalit të pacientëve të paraqitur në urgjencat e QSUT-së janë shtruar për një mjekim më të specializuar. Nga hetimi epidemiologjik i kryer nga ISHP-ja dhe NJVKSH-ja Tiranë rezultoi, se kishim të bënim me një shpërthim me origjinë virale sepse nga ekzaminimi i mostrave të fecëve të ardhura në ISHP, në “Laboratorin e Enterobaktereve” rezultoi, se shumica e mostrave ishin Rotavirus, Adenovirus dhe Norovirus. Në total janë marrë 56 tamponë rektale të cilat rezultuan: 37 mostra negativ, 5 mostra fecesh me Salmonella

Stanleyville dhe një pozitiv me *Campylobacter jejuni* spp. nga Lapraka të cilët mund të jenë bartës ose raste sporadike, dhe nuk kanë lidhje me shpërthimin.

Gjatë muajit shtator 2019 janë raportuar 44 raste me Salmonelozë jotifoide të konfirmuara (1.57/100.000 banorë) dhe peshën kryesore e ka qyteti i Shkodrës (1.11/10.000 banorë). Rrethi i Shkodrës vazhdon të ketë peshën kryesore të incidencës së Shigelozës për muajin shtator 2019 me 50 raste (1.79/10.000 banorë) të konfirmuara në Laboratorin Mikrobiologjik të NJVKSH-së Shkodër, që u përkasin grup-moshave të ndryshme.

Gjatë muajit shtator janë raportuar dy raste të konfirmuara me Tifo abdominale nga rrethi Tiranë dhe Durrës. Pacientja nga Tirana është banore në një fshat të Tiranës 24 vjeç, dhe pacientja nga Durrësi 42 vjeç është banore në Katund Sukth, dhe është shtruar në Spitalin Rajonal të Durrësit, Shërbimi i Infektivit. Diagnoza është konfirmuar për të dyja rastet nga Laboratori i Bakteriologjisë ISHP. Janë marrë kampione uji të pijshëm në vatër dhe në zonën përreth, të cilat kanë rezultuar brenda normave si nga ana fiziko-kimike dhe mikrobiologjike. Koprokulturat e personave të kontaktit kanë rezultuar negativ.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin shtator 2019

(Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste shtator 2019	Incidenca shtator 2019 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	2	0.07
Salmonelozë	44	1.57
Shigelozë (Disenteri bacilare)	56	2
Dizenteri amebike	0	0
Helmime ushqimore	166	5.93
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	12909	461.01
Sëmundje diarreike në total	13175	470.51

2. Sëmundjet e parandalueshme nga vaksinat (EPI)

2.1. Fruthi

Gjatë muajit shtator 2019 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së Fruthit janë dyshuar në total 2 raste të cilat kanë rezultuar negativ nga Korça dhe Kukësi. Ndërkohë që në të njëjtën periudhë, një vit më parë në shtator 2018, në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së Fruthit janë dyshuar në total 37 raste, prej të cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv vetëm 18 raste. Nga këto, 17 raste i përkasin rrethit të Tiranës dhe 1 rast rrethit të Krujës. Rastet pozitive i përkasin kryesisht grup-moshës pediatrike (0-14 vjeç) me 11 raste, nga të cilat 7 raste janë në grup-moshën nën 2 vjeç. Kjo vazhdon të jetë grup-mosha më e prekur për shkak edhe të mosvaksinimit, kontaktit apo vizitës së mëparshme të tyre në Shërbimin Pediatrik të QSUT-së. Të gjitha rastet janë konfirmuar në Laboratorin e Virologjisë në ISHP.



Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për Fruth, sipas datës së fillimit të rashit, shtator 2018.

2.2. Tuberkulozi Pulmonar

Bazuar në të dhënat e Pasqyrës 14/Sh, gjatë muajit shtator 2019 janë raportuar 10 raste të reja me Tuberkuloz Pulmonar (TB) (0.36/100.000 banorë). Rastet pulmonare sputum pozitiv janë raportuar nga rrethet: 2 raste kanë

raportuar përkatësisht Tirana, Durrësi, Laçi dhe Lushnja, dhe nga një rast kanë raportuar përkatësisht Bulqiza dhe Mati. Rastet e raportuara në muajin shtator i përkasin moshës mbi 15 vjeç.

3. Zoonozat

Gjatë muajit shtator 2019, me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14/Sh, është raportuar nga NJVKSH-ja Pogradec një rast i mundshëm me Brucelozë, mashkull i grup-moshës 25-29 vjeç, nga një fshat i Pogradecit.

Gjatë muajit shtator 2019 janë raportuar dy raste me antraks kutan, një i dyshuar dhe një i konfirmuar, përkatësisht nga rrethet Tiranë dhe Tepelenë.

Pacienti i konfirmuar me antraks është mashkull, me profesion bari, 42 vjeç, me vendbanim në Matohasanaj, Tepelenë, fshat i njohur si vatër antraksi dhe ka therur delet e veta dhe të xhaxhait. Pacienti ka një plagë kutane në gishtin e vogël të dorës së majtë, e ngjashme me antraks kutan. Ai deklaron, që për shkak të profesionit ka kaluar antraks shumë vite më parë. Janë marrë të gjitha masat nga NJVKSH-ja Tepelenë dhe Shërbimi Veterinar për vlerësimin e situatës dhe për marrjen e masave.

**Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike në shtator 2019
(Incidenca raste/100.000 banorë)**

	Raste shtator 2019	Incidenca shtator 2019 (raste/100.000 banorë)
Antraks (Plasje)	2	0.07
Brucelozë	1	0.04
Leptospirozë	4	0.14
Leishmaniazë viscerale	1	0.04
Leishmaniazë kutane	0	0

4. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit shtator 2019, janë raportuar në total 36 raste me hepatite virale akute (Incidenca 1.29/100.000 banorë), nga të cilat 3 raste janë hepatite virale të paspecifikuara, 29 raste Hepatite Virale B (HBV) ku 27 janë të konfirmuara në laboratorët e NJVKSH-së. Numri i lartë i rasteve të

konfirmuara me HBV, 24 raste në Tiranë, lidhet me numrin e lartë të testimeve për marrjen e librezave shëndetësore dhe shumë prej rasteve janë bartës të Hepatitit B.

Në lidhje me Hepatitin Viral C (HCV) në Pasqyrën 14/Sh janë raportuar 4 raste, dhe 3 janë raste të konfirmuara nga NJVKSH-ja Tiranë.

5. HIV/AIDS

Në muajin shtator 2019 janë kryer në total 35 ekzaminime për HIV, 23 meshkuj, 7 femra dhe për 5 raste nuk kemi të dhëna. Nga këto ekzaminime, 11 prej tyre kanë rezultuar pozitive (5 meshkuj, 3 femra dhe për 3 raste nuk kemi të dhëna). Rastet pozitive i përkasin moshave të ndryshme, përkatësisht nga 20 deri 74 vjeç. Rastet pozitive janë nga rrethet Elbasan, Durrës, Korçë, Tiranë dhe Përmet. Mostrat e gjakut që kanë rezultuar pozitive kanë ardhur në ISHP nga NJVKSH-ja Korçë, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë, Spitali Infektiv QSUT, Spitali Amerikan dhe Laboratori Intermedica. Tri raste janë pa të dhëna sepse janë kapur nga studimi i “Survejances se integruar biologjike dhe te sjelljes ne Shqiperi”.

INSTITUTI I
SHËNDETIT PUBLIK

DEKSI